

## **Programi i Shkëmbimit të EJTN: Ftesë për aplikime në semestrin e 2-të të Vizitave Studimore**

Të nderuar gjyqtarë dhe prokurorë,

Duke shpresuar që jeni mirë.

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë që EJTN ka lëshuar ftesën e dytë për aplikime **në vizitat studimore që do të organizohen nga EJTN në semestrin e 2-të 2021.**

Ngjashëm sikur në semestrin e parë, EJTN mund ti pranojë kandidatët nga Kosova në vizitat studimore online të cilat nuk paraqesin kosto dhe nëse ka vende të lira. Vizitat online to të organizohen **në Gjykatën Evropianë për të Drejtat e Njeriut, Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore dhe në Eurojust.**

Bashkëngjitur është përshkrimi i secilit program të vizitës studimore online, përfshirë datat dhe grupet në fokus. Ju lutem kini parasysh që formati I vizitave të organizuara në **institucionet e BE-së dhe Konferenca e Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare** ende nuk janë konfirmuar. Gjyqtarët/prokurorët nga Kosova mund të aplikojnë edhe për këto vizita dhe të marrin pjesë nëse këto do të mbahen online. Në rast se nuk mbahen online në do t'ju njoftojmë me kohë.

Nëse ka gjyqtarë/ prokurorë/ trajnues gjyqësor të interesuar për semestrin e dytë të vizitave studimore, Akademia e Drejtësisë së Kosovës do t'ju shtojë në listën përkatëse të vizitave (SV/ECtHR 2021; SV/CJEU/2021; SV/FRA/2021; SV/Eurojust/2021; SV/EU/2021; SV/HCCH/2021) në platformën e Programit të Shkëmbimit <https://exp-platform.ejtn.eu/ospe/activities> **deri me 2 Korrik 2021, 18:00 për vizitat e muajit Shtator, dhe deri me 6 Gusht për vizitat pas muajit shtator.**

Numri i aplikimeve sipas vendeve që do të zgjedhen do të përcaktohet gjatë procesit të alokimit varësisht prej numrit të vendeve në dispozicion.

Çdo të mirë,

Akademia e Drejtësisë